Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ardian Behra	**09.10.2023**	**20.10.2023**	**2023/0750**
Eksperti Teknik **Ernest Kërqeli**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **10.10.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.10.2023, OE "RED by Besa Security L.L.C."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0750, , kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Tetroniks"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Instalimi i sistemit te kamerave ne Qendren Korrektuese ne Dubrave" me nr. të prokurimit: "33600-23-7047-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 65,000.00 €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0750 i dt:02.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 - Qellimi
Neni 6 - Barazia ne Trajtim / Jo Diskriminimi
Neni 7 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 28 - Specifikimet Teknike
Neni 59 - Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve
Udhezuesi 001/2023 per Prokurimin Publik

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

1. Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Sipas Nenit 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 Aneksi 2.	**1.Deklaratë nën betim, pjes e dosjes së tenderit (e vulosur dhe e nenshkruar)**
2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve apo keni marrveshje me AKT-ne per shlyerjen me keste te borxhit së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.	**2. Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik.**
3.Vërtetimin nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.- Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" - te jete i lëshuar se paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.	**3.Vërtetimin nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.**

Dokumentet (nën 2 dhe 3) do kërkohen vetëm nga Operatoret Ekonomik fitues të cilit synohet dhënia e kontratës, para publikimit të dhënies së kontratës (ne origjinale ose kopje e noterizuar) Dështim në dorëzim të dokumenteve të Dështim në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale:** **1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit**	*Dëshmia e kërkuar d* **1. Certifikata e r biznesit (Numri u**
		2. Certifikata e TVSH-se	**2.Certifikata e për TVSH**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **Qarkullimi vjetor për tri vitet e shkuara (2020-2022) minimum 100,000.00 Euro**	*Dëshmia e kërkuar d* **Deklaratat Tatim dorëzuara në Tatimore të Koso i themelimit ap auditua nga nd licencuar.**

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe profesional:** **1.Operatori Ekonomik duhet të ketë të perfunduar me sukses kontrata ne vlere jo me pake se 80,000.00 € për furnizime, instalime, pune te ngjajshme ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate.**	*Dëshmia e kërkuar d* **1. Një listë ku s gjitha kontratat rëndësishme të natyrës se ng realizuara në shkuara duke sak e kryera, shumën vendin, datën dh 1.1 Listës duhet b si dëshmi - kur bërë për një aut në Kosovë ose tjetër, kopjet e raportet e pranim të lëshuar ose nënshkruara nga tillë. Te gjitha duhet te kenë realizuar. Kur realizuar me ekonomik, për dë aktiviteti shërben dokumenti të nën punëdhënësi dhe punëve të përfund**
		2. Operatori Ekonomik duhet te ofroj katallog apo ofertë teknike duke pershkruar	**2.Katallog apo o me pershk specifikacioneve t**

		specifikacionet teknike te cilat i ofron specifikacionet duhet të jene të kjarta dhe të detajuara.	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Instalimi i sistemit të kamerave në Qendrën Korrektuese në Dubravë

Nr. i Prokurimit	**33600-23- 7047 -5-2-1**

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	FATI SECURITY SH.P.K. Komoran	49726.60 €
2.	ELEKTRA L.L.C, Hani i Elezit	56863.96 €
3.	InterAdria L.L.C., ALI KELMENDI NR.28, -, PRISHTINË	78093.00 €
4.	TETRONIKS L.L.C, PRISHTINË	57694.52€
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik RED by Besa Security L.L.C.; K.S. Besa Security SH.P.K., Vetërnik, 10000, Prishtinë	52668.00 €
6.	" KOSPROD " SH.P.K., Rr. Nena Tereze, 12000, Fushe Kosove	56913.44 €
7.	" TECO " SH.P.K., Rr. Ndue Përlleshi, 10000, Prishtinë	47219.00 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Shërbimi Korrektues i Kosovës shpërblen me kontratë: TETRONIKS L.L.C, PRISHTINË , me numër fiskal: 810863325, në vlerë totale të ofertës 57694.52€

Data: 13.09.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Gëzim N

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **RED by Besa Security L.L.C.**

KËRKESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES OFERTA E OPERATORIT EKNOMIK Pozicioni 1. Furnizimi dhe montimi i IP□kamerave statike, bullet apo dome (sipas pozitës), antivandale, me mbajtës për mur/tavan. Pixel: 5MP IR të integruar Protection: IP66 Broshura me numër rendor 1.2. AK ka kërkuar format bullet, OE ka dorëzuar format mini bullet. OE mund të ofertojnë vetëm me pajisje ekuivalente ose më të mira. Kjo pikë nuk e përmbush kërkesën e AK. Arsyetim pse kjo pikë nuk e përmbush kërkesën e AK? AK ka kërkuar format të kamerave bullet, kamera që janë më të mëdha, bien në sy më shumë si dhe vendosen kryesisht për të frikësuar/larguar keqbërësit dhe për t'ua bërë me dije se në atë vend ka kamera! Ndërsa, formati i ofruar nga OE i rekomanduar është format mini-bullet, që është kamerë më e vogël në madhësi, vërehet më vështirë, dhe kryesisht instalohet në vende më diskrete ku përdoruesit nuk dëshirojnë që kamerat të biejnë në sy. Përgjigja e AK për Pretendimin 1: 1. Ne kemi kërkuar kamerë bullet për instalim në ambiente të jashtme dhe dome për instalim në ambiente të brendshme. Me rëndësi është që kamera të ketë formën siq kemi kërkuar për instalim në ambient të caktuar. Ne, nuk kemi specifikuar dhe kufizuar dimenzionet apo madhësinë e kamerës, me rëndësi është që kamera e jashtme të jetë në formë bulleti dhe e brendshme në formë dome. Megjithatë, forma dhe madhësia e kamerës nuk afekton në karakteristikat teknike të kërkuara. Kamera posedon rezolucion 5MP, IR të integruar dhe është antivandale. Kundërpërgjigje ndaj AK për Pretendimin 1 Të nderuar, AK më sipër e pranon edhe vet që ka kërkuar kamerë të formatit bullet, dhe se OE i cilësuar i suksesshëm ka ofruar kamerë të formati tjetër të quajtur mini-bullet, format që nuk është ekuivalent apo më i mirë. Pra, AK po e lejon OE që të ofrojë produkte që nuk i përmbushin 100% specifikat teknike, në këtë rast po e favorizon këtë OE, duke rënë ndesh drejtpërdrejtë

me Nenin 6 të LPP – Barazia në Trajtim / Jo Diskriminimi. Po ashtu, AK po vepron kundër Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, ku specifikohet se në rast të problemeve si në vijim: Problemi: Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara Si te veprohet? Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Neni i LPP-së: 69

Shqyrtimi Teknik I pretendimeve te anekeses 0750/2023 te aktivitetit te prokurimit 33600-23-7047-5-2-1

1 Pretendimi ankimor që ka të bëjë me **pozicionin 1** ***Furnizimi dhe montimi i IP-kamerave statike, bullet apo dome (sipas pozitës), antivandale, me mbajtës për mur/tavan,***

OE ankues argumenton se në dokumentacionin e tenderit (DT), është kërkuar që kamera e instaluar në ambientet e jashtme të jetë në formë "BULLET," ndërsa OE e rekomanduar ka dorezuar një kamerë "MINI BULLET." Megjithatë, eksperti teknik pas shqyrtimit të specifikimeve teknike të detajuar në DT dhe dokumentacionit (katalogut) të paraqitur nga OE i rekomanduar për kontratën, arrin në përfundimin se ofertat e tyre përmbushin specifikat e kërkuara.

Specifikacionet e kërkuara në DT përfshijnë formën "BULLET," rezolucionin 5MP, teknologjinë e ndriçimit të natës (IR), dhe natyrisht, që kamera të jetë antivandal. Nuk janë specifikuar detaje shtesë, si këndi i mbulimit, zona e instalimit, ose distancat e përdorimit.

Duke pasur parasysh që DT nuk ka specifikuar të dhëna shtesë që do të mund të bënin ndryshimin midis një kamere "BULLET" dhe një kamere "MINI BULLET," eksperti teknik mendon që oferta e OE të rekomanduar përmbush kërkesat e specifikave teknike të dokumentacionit të tenderit.

Prandaj, bazuar në argumentin dhe spjegimin e dhënë më sipër, eksperti teknik mendon se ankesa e OE ankues është e **PA BAZUAR.**

KËRKESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES OFERTA E OPERATORIT EKNOMIK Pozicioni 2 - Furnizimi dhe montimi i Switch POE me 8 porta për kamera me IP, rack mount dhe me SFP porta. Broshura me numër rendor 2. AK ka kërkuar që switch të jetë rack mount, ndërsa switchi i dorëzuar nga OE nuk është rack mount por për kuti të siguresave (DIN Rail). Kjo pikë nuk e përmbush kërkesën e AK. Për çdo rast e kemi shiquar edhe rack kabinetin e kërkuar nga AK në pozicionin 10, mos rastësisht e ka të integruar DIN Rail, mirëpo sipas katalogut të dorëzuar nga OE me numër rendor 10., kjo nuk figuron në katalog. Serish kjo pikë nuk e përmbush kërkesën e AK. Arsyetim pse kjo pikë nuk e përmbush kërkesën e AK? AK ka kërkuar Switch i cili është rack mount, kjo kërkesë përveç që është specifike, është edhe shumë e kjartë. Po ashtu, AK ka kërkuar edhe furnizim me rack 6U, pra, pajisjet janë të planifikuara që të instalohen brenda rack cabinetëve 6 unit. Ky instalim bëhet në formë horizontale. Njejtë edhe më poshtë ku kërkohet pajisja UPS, kërkohet që edhe ajo të jetë rack mounted. Ndërsa, për këtë pikë OE ka ofertuar me switch që nuk montohet në rack, por

montohet ne DIN rails. DIN rails janë rails metalike të standardizuara që përdoren zakonisht në ambiente industriale për instalimin e komponentëve të ndryshëm të kontrollit dhe automatizimit. Swichat që montohen në DIN rail janë kompakte dhe montohen në formë vertikale në kutia të siguresave, apo në panela të kontrollit ose enclosure boxes. Switchat që janë rack mount janë të projektuar për montim në rack të pajisjeve standard prej 19", të cilat vendosen zakonisht në qendra të të dhënave, dhoma të serverëve, qendra të monitorimit, etj. Switchat varësisht nga madhësia i kanë edhe aksesorët apo vesh.

Foto nga interneti për ilustrim – instalimi i pajisjeve ne DIN Rails. (E ofertuar nga OE)

Foto nga interneti per ilustrim – instalimi i pajisjeve ne rack cabinet: (E kërkuar nga AK)

Përgjigja e AK për Pretendimin 2:
Switchi është kërkuar të jetë me 8 porte PoE dhe port SFP. Nga broshura e OE kemi konstatua
që switchi i ofertuar është për përdorim industrial me 8 porte PoE me kapacit
10/100/1000Mbps (Gigabit) dhe 2 porte SFP me kapacitet Gigabit dhe plotëson kërkesa
teknike andaj OE është i obliguar të bëjë montimin e tij në rack apo kudo që është e nevojshm
gjatë instalimit.

Kundërpërgjigje ndaj AK për Pretendimin 2
Të nderuar,

AK në këtë përgjigje po mundohet t'i ikë faktit se ka kërkuar që te karakteristikat e switchit ësh kërkuar që të jetë rack mount. Ndërsa, tani kushtimisht kërkesën që switchi të jetë rack-mou AK po e "largon" si kriter, duke thënë që montimi i switch mund të bëhet në rack apo kudo është e nevojshme. Në raste të tilla, AK duhet ta precizoj që kjo është opcionale, mirëpo, këtë rast, ka qenë specifikë e detyrueshme e cila duhet të përfillet 100% - gjë të cilën O cilësuar si i suksesshëm nuk e ka mbuluar. Cka është paradoksale është që ne, bashkë OE tjerë, të gjithë jemi eliminuar për shkak të mos-përfilljes së ndonjë specifike që ka qenë specifikimet teknike, shembulli si me poshtë:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Oferta e juaj është e pa përgjegjshme në aspektin teknik, Nuk e keni përmbush specifikacionin teknik sepse nuk keni sjellur dëshmi për këto pika: Në piken nr. 1. mungon (kamerës se jashtme) specifika antivandal, dhe pika nr. 18 i mungon rezolucioni 4K sipas specifikes teknike te detyrueshme.

RED TECHNOLOGIES

By BESASECU

Pra, në foton e mësipërme nga arsyetimi i AK për eliminim është se mungon X specifika. Ës rasti i njejtë edhe me këtë switch, mungon specifika rack-mount:

2	Furnizimi dhe montimi i Switch POE me 8 porta për kamera me IP, rack mount dhe me SFP porta.	Copë	29

Ndërsa, te rasti i këtij OE i rekomanduar si i suksesshëm, AK-në nuk po e pengon që nuk ja përmbushur të gjitha specifikat **e detyrueshme**.

Sërish, edhe në këtë pikë AK po bie ndesh me Nenin 6 të LPP duke e favorizuar një OE. E ashtu, nuk po vepron sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 ku specifikohet se në rast të probleme si në vijim:

Problemi: Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara
Si te veprohet? Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.
Neni i LPP-së: 69

2.Pretendimi ankimor qe ka te beje me**pozicionin 2 - *Furnizimi dhe montimi i Switch POE me 8 porta për kamera me IP, rack mount dhe me SFP porta.***

OE ankues argumenton se në dokumentacionin e tenderit (DT), është kërkuar që "Switch" të jetë "RACK MOUNT," ndërsa OE e rekomanduar nuk ka paraqitur një pajisje të tillë. Megjithatë, eksperti teknik pas shqyrtimit të specifikimeve teknike të detajuara në DT dhe dokumentacionit të OE të rekomanduar, konfirmon se oferta përmbush kërkesat teknike të specifikave teknike të tenderit, përveç formës së kërkuar të pajisjes që të jetë "RACK MOUNT." Siç është kërkuar në DT, si do të jetë OE ka pasur mundësi që të e sqaron këtë ceshtje me anë të pytjeve për sqarime shtesë.

Prandaj, bazuar në të dhënat e paraqitura eksperti teknik, mendon se pretendimi i OE ankues në këtë çështje është **I BAZUAR.**

PRETENDIMI 3 KËRKESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES OFERTA E OPERATORIT EKNOMIK Pozicioni 4 - Furnizimi dhe shtrirja e kabllos UTP cat 6e, për kamerat IP si dhe terminimi me konektor RJ45 me skelet të metalit për çdo kamerë apo pikë. Broshura me numër 4. AK ka kërkuar kabllo të kategorisë cat 6e, OE ka dorëzuar kabllo cat 6. Po ashtu, nga AK janë kërkuar edhe konektorët RJ45 me skelet të metalit, OE nuk ka dorëzuar katalogun apo ndonjë fotografi apo dëshmi të këtij konektori. Kjo pikë nuk e përmbush kërkesën e AK. Arsyetim pse kjo pikë nuk e përmbush kërkesën e AK? Kabllot UTP (Unshielded Twisted Pair) CAT6 dhe CAT6e janë të dy lloje të kabllove Ethernet të përdorura për lidhjet e rrjetit, por ka dallime në specifikat dhe aftësitë e tyre të performancës. Këtu janë dallimet kryesore midis tyre: Performanca dhe Kapaciteti i Bandwidth: CAT6: Kabllot CAT6 janë projektuar për të mbështetur Ethernet Gigabit (1,000 Mbps) dhe ofrojnë një kapacitet të bandwidth deri në 250 MHz. Ata ofrojnë performancë të shkëlqyeshme për shumicën e aplikacioneve të rrjetit dhe janë të përshtatshëm për transmetimin e të dhënave me shpejtësi të lartë. CAT6e: CAT6e (ose CAT6e – enhanced - i përmirësuar) është një version i përmirësuar i kabllës CAT6. Ai ka një kapacitet më të lartë të bandwidth deri në 500 MHz. Kjo bandwidth e rritur lejon CAT6e të mbështesë Ethernet 10 Gigabit (10,000 Mbps). Kabllo e ofruar nga OE është e kategorisë CAT6, që ka bandwidth deri në 250 Mbit/s (ekuivalente 250 MHz), ndërsa AK ka kërkuar të kategorisë CAT6e që ka bandwidth deri në 500MHz. Po ashtu, AK ka kërkuar që konektorët të jenë RJ45 të metalit. OE nuk ka ofruar asnjë katalog ose fotografi të konektorëve që do të përdoren. Përgjigja e AK për Pretendimin 3: Pas analizimit të broshurës së kabllit UTP CAT6 kemi konstatuar që ky kabëll ka brez frekuencor të funksionimit deri në 300MHz, dhe sipas gjerësisë së brezit, ky kabëll mund të mbështesë transferimin e të dhënave deri 250Mbps. Në rastin tonë, kamera e kërkuar është e rezolucionit 5MP, lëshimi i saj në punë me rezolucionin maksimal prej 5MP kërkon përafërsisht 7 deri 8Mbps, që i bie të shfrytëzoj vetëm 2.8% deri 3.2% të kapacitetit që ofron ky kabëll. Ne kemi kërkuar që të bëhet furnizimi dhe instalimi i sistemit, andaj operatori ekonomik e ka për obligim edhe terminimin e kabllove me konektor RJ45 me skelet metalik ashtu siç është kërkuar në Aneksin 1. Për më tepër, konektori është pozicion i përbërë në kërkesën e pozicionit të kabllos. Kundërpërgjigje ndaj AK për Pretendimin 3 Të nderuar, Edhe në pretendimin 3, AK e pranon se OE ka ofruar pajisje që nuk i përmbush specifikat e kërkuara, megjithatë AK po e lejon këtë gjë! Pra, AK pranon që OE nuk ka dorëzuar kabllo CAT6e sipas kërkesës, kabllo e cila ka bandwidth deri në 500MHz, dhe pranon se OE ka dorëzuar kabllo CAT6, kabllo e cila ka bandwidth deri në 300MHz. Mirëpo, sipas AK, edhe pse kjo specifike nuk është përmbushur nga OE, kjo është në rregull pasi që nuk pengon në transferin e të dhënave. Pra, AK me vetëdije të plotë nuk po

vepron sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 ku specifikohet se në rast të problemeve si në vijim: Problemi: Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara Si te veprohet? Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Neni i LPP-së: 69 Po ashtu, edhe konektori që AK e ka cilësuar si pjesë përbërëse të kabllos – gjë që nuk qëndron pasi që konektori është pajisje komplet e ndarë, mirëpo vendoset në kabllo, OE nuk ka ofruar dëshmi që do të përdorë konektor të tillë me skelet metalik, gjë që duhet të shpie në eliminim direkt. Se nuk mjafton vetëm deklarata e AK por duhet dorëzuar edhe dëshmi, AK e ka vërtetuar edhe ne këtë tender, edhe në tenderin e kaluar duke eliminuar shumë operatorë ekonomik. Mirëpo, pse po ndryshon çasje AK në këtë rast, edhe shumë e çuditshme dhe len për të dëshiruar. Edhe njëherë, po e potencojmë që ky OE nuk ka ofertuar me produkte ekuivalente që i përmbushin 100% specifikimet teknike të detyrueshme, e as me produkte më të mira, por me produkte më të dobëta.

3.Pretendimi ankimor qe ka te beje me **pozicioni 4** - ***Furnizimi dhe shtrirja e kabllos UTP cat 6e, për kamerat IP si dhe terminimi me konektor RJ45 me skelet të metalit për çdo kamerë apo pikë***.

OE ankues argumenton se në dokumentacionin e tenderit (DT), është kërkuar që kabllot të jenë "UTP Cat6e," ndërsa OE e rekomanduar ka paraqitur kabllot "UTP Cat6." Megjithatë, eksperti teknik pas shqyrtimit të specifikimeve teknike të detajuara në DT dhe dokumentacionit të ofruesit të rekomanduar, kablloja e ofruar nga OE e rekomanduar nuk përputhet me specifikacionet e kërkuara në dokumentacionin e tenderit, pasi DT kërkon kabllo "UTP Cat6e." Ky ndryshim është teknikisht i rëndësishëm, pasi "Cat6e" është një standard më i avancuar dhe ka karakteristika të veçanta për të punuar me frekuencat më të larta dhe për të mbështetur transmetimin me shpejtësi të lartë në distanca më të gjata(up to 100m), OE ka pasur mundësi që të e sqaron këtë ceshtje me anë të pytjeve për sqarime shtesë.

Gjithashtu, për sa i përket konektoreve RJ45 me skelet metalik, Me që është kërkuar të bëhet furnizimi dhe instalimi i të gjithë sistemit/pajisjeve dhe kabllove OE do të duhej të bënte terminimin e kabllove konfrom kërkesave të DT.

Për këto arsye, eksperti teknik arrin në përfundimin se pretendimi i OE ankues në këtë çështje është **I BAZUAR** dhe se oferta e OE të rekomanduar nuk përputhet plotësisht me specifikacionet e kërkuara në DT.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që

lënda të kthehet në rivlerësim.

Sqarim, të gjitha pretendimet ankimore jan shqyrtuar nga Ekspeti Teknik.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **RED by Besa Security L.L.C.**

Ardian Behra

Ernest Kërqeli